

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI KATËRT

ÇËSHTJA CAKA K. SHQIPËRISË

(Ankimi nr. 44023/02)

VENDIMI

STRASBOURG

8 dhjetor 2009

Ky vendim merr formë përfundimtare në rrethanat e parashikuara në nenin 44§ 2 të Konventës. Vendimi mund të jetë objekt rishikimesh redaktimi.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni katërt), me trup gjykues të përbërë nga:

Nicolas Bratza, kryetar,

Lech Garlicki,

Giovanni Bonello,

Ljiljana Mijović,

Päivi Hirvelä,

Ledi Bianku,

Nebojša Vučinić, gjyqtarë,

and Lawrence Early, sekretar i seksionit,

pas shqyrtimit me dyer të mbyllura, më 17 nëntor 2009,

merr në këtë datë vendimin e mëposhtëm:

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në një ankim (nr.44023/02) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës sipas nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa) nga nënshtetasi shqiptar, z. Lulzim Caka (ankuesi), më 28 nëntor 2002.

2. Ankuesi i cili kishte përfituar ndihmë ligjore u përfaqësua nga z. P. Rama dhe z. B. Rusi, avokatë që ushtrojnë profesionin e tyre në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentët e atëhershëm të saj znj. B. Bullica dhe znj. S. Meneri.

3. Ankuesi pretendonte shkelje të nenit 3 të Konventës për mungesë të ndihmës mjekësore të domosdoshme dhe të mjaftueshme në kohën që ai ishte i arrestuar, duke pasur parasysh dëmtimet serioze që ai kishte pësuar. Ai gjithashtu është ankuar sipas nenit 5 § 3 të Konventës, për kohëzgjatjen e periudhës së tij të paraburgimit. Sipas nenit 6 § 3 (c) dhe (d) të Konventës, ai është ankuar se i ishte mohuar e drejta e një procesi të rregullt gjyqësor.

4. Më 9 shkurt 2006, kryetari i seksionit të katërt të Gjykatës vendosi ta njoftojë Qeverinë për ankimin. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos që meritat e ankimit të shqyrtoheshin në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tij.

5. Secila nga palët, ankuesi dhe qeveria paraqitën vëzhgimet e tyre me shkrim (rregulli 59 § 1).

FAKTET

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Ankuesi, z. Lulzim Caka, ka lindur në 1970 dhe aktualisht vuan dënimin në një burg në Tiranë, Shqipëri.

A. Ngjarjet që i paraprijnë arrestimit të ankuesit

1. Vrasja e P.

7. P. u vra më 21 korrik 1997. Në një datë të pacaktuar në 1997 kundër ankuesit u filluan hetimet penale. Gjatë këtyre hetimeve motra e viktimës, A., megjithëse nuk kishte qenë e pranishme në vendin e ngjarjes, ka deklaruar se ankuesi kishte vrarë vëllanë e saj. Ajo e bazonte dëshminë e saj në shpjegimet e tre dëshmitarëve, B., C. dhe D., të cilët rezultuan se u pyetën në një datë të pacaktuar.

8. Më 6 tetor 1998 policia gjyqësore, organi përgjegjës për drejtimin e hetimeve penale dhe identifikimin e autorit, propozoi që të pezulloheshin hetimet penale, meqenëse autori i krimit nuk mund të identifikohet. Megjithatë, më 15 tetor 1998 prokurori depozitoi një padi kundër ankuesit pranë Gjykatës së Rrethit Berat (shiko paragrafin 17 më poshtë).

2. Vrasja e mbetur në tentativë e punonjësve të policisë

9. Në 1997 Shqipëria u godit nga trazirat civile, si rezultat i rënies së skemave piramidale. Depot e armëve u plaçkitën dhe një numër i konsiderueshëm armësh ranë në duart e popullsisë civile. Rivendosja graduale e rendit publik bënë të domosdoshme kontrolle të vazhdueshme të policisë. Rrjedhimisht, më 18 mars 1998 forcat policore të Beratit ngritën pika kontrolli për të ushtruar kontrolle për armëmbajtje pa leje. Pasdite herët në të njëjtën ditë, nëpunësit e policisë në detyrë, në pikën e kontrollit të vendosur në rrugën kryesore ndërmjet qyteteve Berat dhe Fier, qëlluan me armë ankuesin dhe X., një tjetër person që po ngiste motoçikletën bashkë me të. Si rezultat, X. vdiq dhe ankuesi u plagos rëndë.

10. Sipas të dhënave të policisë mbi incidentin, dy personat që po ngisnin një motoçikletë (të identifikuar më vonë si ankuesi dhe X.), nuk ndaluan kur në pikën e parë të kontrollit policia i urdhëroi të ndalonin. Policia në pikën e dytë të kontrollit, dëshmoi se ankuesi, i cili kishte qenë duke ngarë motoçikletën, ka qëlluar në drejtim të punonjësve të policisë me automatik dhe revolver njëkohësisht. Policia i është përgjigjur zjarrit dhe ka qëlluar për vdekje X.,-in, pasagjerin në ndenjësën e pasme të motoçikletës. Pavarësisht faktit që ankuesi ishte plagosur, ai ka vazhduar të qëllojë derisa është dorëzuar. Policia raportoi se ka mbledhur në vendngjarje dy automatikë “Kaleshnikov”, dy pistoletë, plumba dhe gëzhjoja, motoçikletën, një maskë, një kapelë, një palë këpucë tenisi dhe gjëra të tjera që mendohet të jenë përdorur nga ankuesi dhe X. Rezulton që armët automatike, pistoletat, plumbat dhe gëzhjotat janë dërguar për ekzaminim balistik.

B. Arrestimi i ankuesit

11. Më 18 mars 1998 ankuesi dhe një tjetër i dyshuar, E., u arrestuan në lidhje me ngjarjen e mësipërme (shih paragrafin 9-10 më lart).

12. Ankuesi u dërgua në spital, ku ai qëndroi për disa orë për trajtim mjekësor meqenëse ishte plagosur. Pas lirimit nga spitali, në të njëjtën ditë, ai u mbajt në arrest në Berat. Më 19 mars 1998 ankuesi u ekzaminua nga një mjek, i cili e vlerësoi gjendjen e tij shëndetësore përgjithësisht të kënaqshme. U konkludua se plagët që kishte marrë ankuesi ishin nën nivelin e plagëve të lehta të trupit që kërkonin jo më shumë se 9 ditë pushim.

13. Më 19 mars 1998 prokurori akuzoi ankuesin për vrasje të mbetur në tentativë në bashkëpunim me të tjerë dhe armëmbajtje pa leje. Gjatë marrjes në pyetje në të njëjtën ditë, ankuesi nuk ka dhënë asnjë të dhënë në lidhje me akuzat kundër tij. Ankuesi ka kërkuar prezencën e avokatit të tij, F.

14. Më 20 mars 1998 Gjykata e Rrethit Berat konfirmoi ligjshmërinë e arrestimit të ankuesit.

15. Më 8 prill 1998 prokurori vendosi të ndërpriste hetimet penale kundër E., duke vlerësuar që ai nuk kishte kryer asnjë vepër penale.

16. Më 9 qershor 1998, 22 shtator 1998 dhe 15 tetor 1998, i pyetur nga prokurori, ankuesi është mbrojtur dhe përfaqësuar nga G., një tjetër avokat i zgjedhur nga ai vetë.

17. Më 15 tetor 1998 prokuroria e Beratit depozitoi aktakuzën pranë Gjykatës së Rrethit Berat, duke e akuzuar ankuesin për vrasjen me paramendim të P. dhe vrasjen e mbetur në tentativë të punonjësve të policisë më 18 mars 1998. Rezultoi që u bashkuan të dy procedimet penale kundër ankuesit.

C. Procedurat e gjyimit

1. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Berat

18. Gjykata e Rrethit Berat filloi gjykimin kundër ankuesit më 17 nëntor 1998. Trembëdhjetë seanca gjyqësore janë mbajtur ndërmjet datave 17 nëntor 1998 dhe 13 prill 1999, datë në të cilën procesi gjyqësor iu kalua Gjykatës së Rrethit Fier (shih transferimi i procesit gjyqësor seksioni më poshtë). Shtatë seanca gjyqësore janë shtyrë për shkak të mungesës së prokurorit, ankuesit apo avokatit të tij mbrojtës. Në gjashtë seancat gjyqësore të mbetura, ankuesi është përfaqësuar nga avokati i tij, G.

19. Ankuesi ka kontestuar faktet e paraqitura nga prokuroria. Ai ka dëshmuar se ka qenë i paarmatosur duke ngarë motoçikletën kur forcat e policisë në pikën e dytë të kontrollit kanë hapur zjarr, pa e urdhëruar atë të ndalojë. Gjithashtu ai i ka kërkuar gjykatës të thërrasë dëshmitarët që, në momentin e incidentit, kanë qenë duke udhëtuar në të njëjtën rrugë.

20. Në seancat gjyqësore më 23 dhjetor 1998 dhe 6 janar 1999, katër dëshmitarë të cilët kanë qenë duke udhëtuar në të njëjtën rrugë dhe e kanë parë ankuesin kur po ngiste motoçikletën, kanë dëshmuar se ankuesi nuk kishte asnjë armë me vete.

2. Transferimi i procesit gjyqësor

21. Më 15 shkurt 1999 prokurori depozitoi një kërkesë pranë Gjykatës së Lartë për transferimin e procesit gjyqësor nga Gjykata e Rrethit Berat, kundër ankuesit. Ai argumentoi se për arsye të gjendjes së pasigurisë në Berat, dëshmitarët nguronin për të dëshmuar në gjyq. Gjithashtu ai përmendi ekzistencën e presionit të formave të ndryshme, madje edhe kërcënime për jetë të prokurorit në lidhje me rezultatin e procesit gjyqësor.

22. Më 5 mars 1999 Gjykata e Lartë lejoi transferimin e procesit gjyqësor nga Gjykata e Rrethit Berat në Gjykatën e Rrethit Fier, në përputhje me nenin 94 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

23. Sipas nenit 97 § 3 të KPP-së, Gjykatës së Rrethit Fier iu kërkua të merrte një vendim në lidhje me vlefshmërinë e veprimeve të kryera nga Gjykata e Rrethit Berat. Një vendim i tillë nuk është përfshirë në dosjen e çështjes. Qeveria ka parashtruar se dosja e çështjes dhe veprimet e kryera nga Gjykata e Rrethit Berat janë konsideruar të vlefshme mbi bazën e një vërtetimi të datës 9 mars 1999 të nxjerrë nga sekretarja e Gjykatës së Rrethit Fier.

3. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Fier

24. Më 25 maj 1999 ankuesi caktoi një tjetër avokat mbrojtës me zgjedhjen e tij, H.-në.

25. Më 26 maj 1999 Gjykata e Rrethit Fier filloi gjykimin e ankuesit. Njëzet e katër seanca gjyqësore janë kryer ndërmjet datave 26 maj 1999 dhe 11 maj 2000, datë në të cilën ankuesi u shpall fajtor për veprat penale dhe u dënua me burgim.

26. Nga data 26 maj deri më 27 nëntor 1999 janë planifikuar dhjetë seanca gjyqësore, por janë shtyrë për arsye të mungesës së ankuesit apo përfaqësuesit të tij. Asnjë dëshmitar nuk u dëgjua dhe asnjë masë tjetër procedurale nuk është marrë. Më 9 nëntor 1999 gjykata njoftoi ankuesin që ai mund të caktonte një avokat tjetër mbrojtës duke pasur parasysh mungesën e përsëritur të avokatit të tij H.

27. Më 8 dhjetor 1999 ankuesi revokoi prokurën e H.-së. Nga 8 dhjetor 1999 deri më 7 shkurt 2000, periudhë gjatë së cilës u mbajtën pesë seanca gjyqësore, ankuesi u përfaqësua vetë. Asnjë dëshmitar nuk u paraqit apo nuk u pyet në këto seanca gjyqësore, si rezultat i të cilave ato u shtynë. Më 7 shkurt 2000 prokuroria lexoi dëshmitë e dëshmitarëve që ishin marrë gjatë hetimeve penale. Ankuesi kundërshtoi deklaratat e dëshmitarëve B. dhe D. Në të njëjtën ditë ankuesi ricaktoi avokatin e tij mbrojtës të mëparshëm, H. Gjykata vendosi të pyesë dëshmitarin A. në seancën tjetër gjyqësore më 21 shkurt 2000 në prani të avokatit të ankuesit.

28. Më 21 shkurt 2000 gjyqi dëgjoi dëshminë e A., e cila deklaroi që ankuesi ishte vrasësi i vëllait të saj P. Ajo u bazua në deponimin e dëshmitarëve B., C. dhe D. Ajo nuk ka qenë dëshmitare në vendin e ngjarjes. As ankuesi dhe as avokati i tij, H., nuk e kanë pyetur A. Më tej me kërkesë të ankuesit, Gjykata e Rrethit Fier ka lëshuar disa fletëthirrje për paraqitjen e B., C dhe D. Megjithatë dëshmitarët nuk u paraqitën asnjëherë në gjyq.

29. Në seancën gjyqësore më 23 shkurt 2000 ankuesi caktoi I. si avokatin e tij mbrojtës bashkë me H.-në. Tre punonjës të policisë K., L. dhe M. dëshmuar në gjyq. Bazuar në mospërputhjen nga dëshmia e M.-së në fazën hetimore dhe procesin gjyqësor, prokurori kërkoi leje për të kundërshtuar dëshminë në përputhje me nenin 362 të KPP-së duke lexuar deklaratën e tij bërë gjatë hetimeve penale.

Ndërsa ankuesi dhe avokati I. nuk pyetën fillimisht M., ato kërkuan që ai të pyetej pas leximit të dëshmisë së tij. Gjykata e Rrethit refuzoi kërkesën e tyre meqenëse ato fillimisht kishin hequr dorë nga e drejta e tyre për të pyetur dëshmitarin.

30. Më 1 mars 2000 avokati I. i ankuesit i kërkoi gjykatës të thërriste M. për ta pyetur. Ai e përsëriti kërkesën në seancën gjyqësore më 6 mars. Në të njëjtën datë gjykata refuzoi kërkesën si të pabazuar. Megjithatë ajo lejoi kërkesën e avokatit për të thirrur katër punonjës të tjerë policie N., O., Q. dhe S.

31. Më 15 dhe 21 mars avokati i ankuesit ka përsëritur kërkesën e tij për të thirrur dhe pyetur M.-në. Më 21 mars gjykata ka refuzuar kërkesën si të pabazuar. Ajo gjykoi që M. ka ndjekur një seancë gjyqësore në të cilën i akuzuari dhe avokati i tij kanë pasur mundësinë t'i bënë pyetje atij. Në të njëjtën datë, gjykata ka dëgjuar punonjësën e policisë N. Ankuesi është përfaqësuar nga avokati i tij I. Dëshmitarët O., Q. dhe S. nuk janë paraqitur, si dhe nuk janë pyetur asnjëherë në gjyq, megjithë thirrjet e përsëritura dhe njoftimin dërguar nga gjykata autoriteteve përkatëse, si Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.

32. Më 18 prill 2000 avokati mbrojtës I. i ankuesit u tërhoq nga përfaqësimi i tij. Avokati

tjetër mbrojtës H. i ankuesit, mungonte. Gjykata vendosi të shtyjë seancën gjyqësore më 3 maj 2000.

33. Më 26 prill 2000 avokati mbrojtës H. i ankuesit u tërhoq nga përfaqësimi i ankuesit. Arsytet kishin të bënin me përfshirjen e tij në çështje të tjera penale. Ai gjithashtu përmendi parregullsitë procedurale të kryera nga Gjykata e Rrethit Fier, e cila nuk i kishte dërguar thirrje me shkrim atij për t'u paraqitur në seancat gjyqësore. Ai ka pretenduar se gjykata nuk ka shfaqur paanshmëri. Ai i ka kërkuar gjykatës të procedojë në përputhje me seksionin 49 § 5 i KPP-së.

34. Më 3 maj 2000 ankuesi ka caktuar një tjetër avokat mbrojtës me zgjedhjen e tij, J. Gjykata vendosi të shtyjë procesin gjyqësor deri më 11 maj 2000.

35. Më 11 maj 2000 gjykata ka lexuar një faks të marrë nga avokati mbrojtës J., i ankuesit, i cili deklaronte se përfshirja e tij në biznese të tjera nuk mundësonte mbrojtjen nga ana e tij të ankuesit. J. ka deklaruar se ai nuk kishte marrë asnjë kërkesë për të përfaqësuar ankuesin. Bazuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, ankuesi dëshironte të bënte vetë mbrojtjen e tij. Ai ka deklaruar se ai nuk ka pasur asnjë armë më 18 mars 1998. Ai ka rënë dakord që të lexohen dëshmitë e dëshmitarëve Q., R. dhe S. të marra gjatë hetimeve penale, si dhe ka hequr dorë nga e drejta për të pyetur dëshmitarin O. Prokurori ka proceduar me leximin e dëshmive të dëshmitarëve të sipërpërmendur. Më tej ai ka konkluduar me parashtrimet e tij përfundimtare. Ankuesi për rrjedhojë ka deklaruar se ai nuk i pranonte akuzat meqenëse as nuk kishte vrarë P.-në, dhe as nuk kishte qëlluar punonjësit e policisë.

36. Në të njëjtën ditë Gjykata e Rrethit Fier ka dhënë dënimin, duke e shpallur ankuesin fajtor sipas akuzave dhe e dënoi me njëzet e pesë vjet burgim.

37. Në lidhje me akuzën e vrasjes së mbetur në tentativë të punonjësve të policisë, Gjykata e Rrethit Fier e ka bazuar vendimin e saj në dëshmitë e katër punonjësve të policisë K., L., M. dhe N. dhënë në seancat gjyqësore më 23 shkurt dhe 6 mars 2000 (shih 29 dhe 31 më lart), si dhe në deklaratat e dy dëshmitarëve të dhëna gjatë hetimeve penale. Gjykata mori parasysh raportin hetimor të vendit të ngjarjes, raportin e arrestimit të ankuesit, si dhe raportin balistik.

38. Në lidhje me këtë, gjykata gjithashtu shpalli ankuesin fajtor për armëmbajtje pa leje mbi bazën e raportit balistik, duke shtuar që gëzhojat e gjetura në vendin e ngjarjes janë qëlluar nga armët e gjetura pranë të akuzuarit. Megjithatë, në vendimin e marrë nuk është përmendur nëse armët ishin në posedimin aktual të ankuesit.

39. Në lidhje me vrasjen e P.-së, më 21 korrik 1997, Gjykata e Rrethit Fier e bazoi arsyetimin e saj në dëshminë e A.-së dhënë në gjyq, si dhe në deklaratat e dëshmitarëve B., C., dhe D. dhënë gjatë hetimeve penale (shih paragrafët 7, 27 dhe 28 më lart).

D. Procedimet e apelit

40. Më 16 maj 2000 ankuesi bëri apel kundër dënimit të tij pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, duke pretenduar shkelje të së drejtës së tij për një proces të rregullt gjyqësor. Në veçanti, ai ka argumentuar se mungesa e ndihmës ligjore gjatë gjykimit dhe fakti që gjykata e shkallës së parë ka pranuar deklaratat e dëshmitarëve pa dhënë mundësinë e pyetjeve nga pala kundërshtare, përbënte shkelje të së drejtës së procedurave kundërshtuese. Për më tepër, atij i është privuar e drejta për të pyetur dëshmitarin M., i cili ka dëshmuar në seancën gjyqësore më 23 shkurt 2000. Gjithashtu ai ka argumentuar se, gjatë fazës kur palët kanë bërë parashtrimet e tyre përfundimtare, ai nuk është ndihmuar nga avokati mbrojtës. Ankuesi është përfaqësuar në Gjykatën e Apelit nga I., i cili më parë ishte tërhequr nga çështja më 18 prill 2000 (shih paragrafin 32 më lart).

41. Më 20 tetor 2000 Gjykata e Apelit Vlorë hodhi poshtë kërkesën e ankuesit dhe miratoi vendimin e Gjykatës së Rrethit Fier. Meqenëse apeli drejtohej kundër refuzimit të gjykatës së Rrethit për të lejuar ankuesin të pyesë dëshmitarin M., gjykata e apelit vërejti që gjatë seancës gjyqësore më 23 shkurt 2000 avokati mbrojtës i ankuesit ka dëshmuar se nuk kishte pyetje për të bërë. Ankuesi i ka bërë dëshmitarit vetëm një pyetje, së cilës ky i fundit i është përgjigjur. Gjykata e Apelit ka rrëzuar ankesën e ankuesit për mungesë të ndihmës ligjore në seancën gjyqësore përfundimtare, bazuar në deklaratën e tij se ai dëshironte të bënte vetë mbrojtjen e vet.

42. Më 6 mars 2001 ankuesi i bëri apel Gjykatës së Lartë, bazuar në të njëjtat argumente që kishte bërë pranë Gjykatës së Apelit. Ai shtoi se procesverbali i seancës gjyqësore datë 11 maj 2000 ishte falsifikuar nga Gjykata e Rrethit Fier, duke argumentuar se kërkesa e tij për t'u mbrojtur nga një avokat ishte shtrembëruar për t'u lexuar se ai dëshironte të mbrohej vetë.

43. Më 16 tetor 2001 Gjykata e Lartë deklaroi ankimimin e tij të papranueshëm, meqenëse argumentet e tij ishin jashtë fushës së nenit 432 të KPP-së.

44. Më 22 tetor 2003 ankuesi depozitoi një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese për parregullsinë e procedimeve. Ai u ankua për kohëzgjatjen e periudhës së paraburgimit tij dhe u bazua në nenin 68 3 “b” dhe “c” dhe “d” të Konventës.

45. Më 18 nëntor 2003 Gjykata Kushtetuese, mbledhur në trup gjykues, e përbërë nga tre gjyqtarë, deklaroi ankimin të papranueshëm. Ajo argumentoi se ankimi i ankuesit nuk ngrinte çështje të një procesi të rregullt ligjor, por lidhej me vlerësimin e provave, gjë që kishte të bënte me gjykatat më të ulëta.

E. Parashtrime të mëtejshme

46. Më 6 janar 2003 ankuesi depozitoi pranë Gjykatës një deklaratë të noterizuar nga B.H., gjyqtari që kishte kryesuar trupin gjykues në Gjykatën e Rrethit Berat në procesin gjyqësor. Sipas B.H., procedimet janë transferuar në Gjykatën e Rrethit Fier, në dëm të ankuesit, në një kohë kur Gjykata e Rrethit Berat ishte pranë mbylljes së shqyrtimit të çështjes dhe dukej se po arrinte në përfundimin se nuk kishte prova të mjaftueshme kundër tij. Për më tepër, B.H. mbron mendimin se Gjykata e Rrethit Fier kishte pranuar deklaratat e dëshmitarëve të marra në komisaratin e policisë më shumë se deklaratat e marra gjatë gjykimit pranë Gjykatës së Rrethit Berat. Gjithashtu ai argumentonte se Gjykata e Rrethit Fier nuk kishte marrë në konsideratë raportin balistik të paraqitur gjatë gjykimit pranë Gjykatës së Rrethit Berat, nga ku vërtetohej që armët automatike që pretendohesh se ishin përdorur nga ankuesi, në fakt, i përkisnin forcave të policisë Berat. Për më tepër, ai deklaroi se avokatët mbrojtës të ankuesit ishin tërhequr nga mbrojtja e tij gjatë gjykimit pranë Gjykatës së Rrethit Fier për shkak të kërcënimeve të jetëve të tyre, si dhe familjeve të tyre.

47. Gjithashtu ankuesi depozitoi katër deklarata të noterizuara bërë nga dëshmitarë okularë që kishin qenë prezent disa minuta para incidentit dhe kishin parë ankuesin të paarmatosur duke ngarë motoçikletën dhe kishin dëgjuar të shtënat e policisë. Të njëjtët dëshmitarë okularë dëshmuuan pranë Gjykatës së Rrethit Berat, më 23 dhjetor 1998 dhe 6 janar 1999 (shih paragrafin 20 më lart).

48. Më 28 prill 2008 Gjykata i kërkoi Qeverisë të paraqiste të gjithë dosjen hetimore dhe raportet e lexueshme të të gjitha seancave gjyqësore pranë gjykatave të rretheve. Më 31 korrik 2008 Qeveria paraqiti raportet e të gjitha seancave gjyqësore të mbajtura pranë gjykatave të rretheve. Asnjë dokument nga dosja hetimore nuk është paraqitur.

II. E DREJTA E BRENDSHME PËRKATËSE

A. Kushtetuta

49. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës shqiptare parashikojnë:

Neni 31

Gjatë procedimit penal, kushdo ka të drejtë:

- a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzat e ngritura kundër tij, të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit;
- b) të ketë kohën dhe mjetet e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
- c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;
- ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirshëm dhe privatisht me të; si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;
- d) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, ekspertëve dhe personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

Neni 32

1. Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij.

2. Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

Neni 33

1. Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet.
2. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë.

Neni 42 § 2

Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave ligjore dhe kushtetuese, lirive dhe interesave ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 131

Gjykata Kushtetuese vendos:...

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt gjyqësor, pasi të jenë ezauruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

B. Kodi i Procedurës Penale

50. Kur kërkohet prania e mbrojtësit ligjor dhe mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar nuk është i siguruar, nuk është paraqitur ose ka lënë mbrojtjen, gjykata ose prokurori cakton si zëvendësues një mbrojtës tjetër, i cili ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e mbrojtësit.

51. Nenet 94 deri 97 përcaktojnë transferimin e procedimeve. Sipas formulimit të nenit 94, në fuqi në kohë materiale, në ç'do fazë dhe nivel gjatë gjykimin, kur siguria publike apo vullneti i lirë i njerëzve për të marrë pjesë në një gjykim dëmtohen nga ngjarje lokale të rënda të cilat mund të ndikojnë në kryerjen e gjykimin dhe që nuk mund të shmanget nga mënyra të tjera, Gjykata e Lartë, me kërkesë të arsyeshme të prokurorit ose të pandehurit, mund t'ia transferojë çështjen një gjykate tjetër.

Neni 97 parashikon që Gjykata e Lartë vendos në fshehtësi. Vendimi për të lejuar që një kërkesë për çështjen që do transferohet, i bëhet i ditur gjykatës në të cilën janë kryer procedimet, si dhe gjykatës së cilës do t'i transferohen procedimet. Gjykata e cila i ka kryer procedimet më parë duhet t'i transferojë menjëherë dokumentet procedurale gjykatës së caktuar dhe urdhëron njoftimin e vendimit të Gjykatës së Lartë prokurorit, të pandehurit dhe palëve private. Neni 97 § 3 deklaron që gjykata e caktuar nga Gjykata e Lartë jep vendimin nëse veprimet e kryera janë të vlefshme, si dhe shtrirjen e vlefshmërisë së tyre.

52. Sipas nenit 362 § 1 në fuqi në kohë materiale, me qëllim që pjesërisht apo tërësisht të kundërshtohet përmbajtja e dëshmisë ose kur dëshmitari refuzon të dëshmojë, palët mund të përdorin deklaratat që janë dhënë paraprakisht nga dëshmitarët pranë prokurorit apo policisë gjyqësore, deklarata të cilat gjenden në dosjen e çështjes, por vetëm pasi dëshmitari ka dëshmuar për faktet dhe rrethanat që mund të kontestohen. Neni 362 § 2 përcakton se këto deklarata nuk përbëjnë të dhëna për faktet në lidhje me këtë rast, por ato mund të shqyrtohen nga gjykata me qëllim që të përcaktohet besueshmëria e personit në fjalë dhe janë pjesë përbërëse e dosjes së çështjes.

53. Neni 425 përcakton fushën e shqyrtimit të apelimit nga gjykata e apelit. Ai parashikon që shqyrtimi i çështjes nga gjykata e apelit nuk kufizohet në argumentet e apelit, por shtrihet në tërë çështjen.

54. Sipas nenit 427, me kërkesën e palës, gjykata e apelit ka autoritetin të rishqyrtojë drejtpërdrejt të dhëna të mëparshme dhe materiale të reja shtesë, nëse e quan të domosdoshme.

55. Neni 428 përcakton vendimet që mund të merren nga gjykata e apelit. Ai parashikon që gjykata e apelit mund të vendosë të pezullojë apelimin dhe të miratojë vendimin, të ndryshojë vendimin, të shfuqizojë vendimin dhe të përfundojë procedimet penale, ose të shfuqizojë vendimin dhe ta kalojë çështjen për gjykim të ri.

56. Vendimet e gjykatës së apelit mund të ankimohen pranë Gjykatës së Lartë në përputhje me një nga kërkesat e mëposhtme të nenit 432: a) e drejta penale nuk është respektuar apo është zbatuar gabimisht; b) ka pasur shkelje, të cilat kanë rezultuar në deklarinimin e vendimit të gjykatës të pavlefshëm në përputhje me nenin 128 të këtij Kodi; c) ka pasur shkelje të rregullave procedurale, të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit.

57. Neni 434 parashikon që Gjykata e Lartë shqyrton apelimin në rastet kur pikat e së drejtës

janë ngritur për këtë problem.

E DREJTA

58. Ankuesi ka ankuar sipas nenit 3 të Konventës për pamjaftueshmërinë e trajtimit mjekësor që ai ka marrë gjatë periudhës së paraburgimit. Ai i është referuar plagëve që ka pësuar në konfrontimet me policinë, më 18 mars 1998. Neni 3 shprehet si më poshtë:

“Askush nuk duhet t’i nënshtrohet torturës ose trajtimit çnjerëzor e degradues apo dënimit”.

59. Ankuesi gjithashtu u ankua për kohëzgjatjen e mbajtjes së tij në arrest. Gjykata shqyrton kërkesën e tij sipas nenit 5 § 3 të Konventës që lexohet si më poshtë:

“Çdokush i arrestuar apo i ndaluar në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 (c) të këtij neni ka të drejtën ... e gjykimit brenda një periudhe kohe të arsyeshme apo të lirohet në pritje të gjykimit. Lirimi mund të kushtëzohet me garancitë për t’u paraqitur për gjykim”.

60. Ankuesi u ankua më tej sipas nenit 6 § 3 (c) dhe (d) të Konventës se atij i ishte mohuar e drejta e një procesi të rregullt ligjor, meqë ai nuk ishte mbrojtur siç duhet nga një avokat dhe që nuk kishte mundur të pyeste dëshmitarët apo të siguronte paraqitjen e dëshmitarëve në emër të tij. Pjesa përkatëse e nenit 6 të Konventës lexohet si më poshtë:

1. Në përcaktimin e çdo akuze penale kundër tij çdo kush ka të drejtën e një procesi ... të rregullt ... gjyqësor nga ... gjykata...;

3. Çdokush i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

c) të mbrojtë veten privatisht apo nëpërmjet ndihmës ligjore, me zgjedhjen e tij ose, nëse nuk ka mjetet e nevojshme për të paguar ndihmën ligjore t’i paguhet falas, nëse e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d) të pyesë apo të ketë pyetur dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë ndjekjen dhe pyetjen e dëshmitarëve në emër të tij në të njëjtat kushte me ato të dëshmitarëve kundër tij.

...

PRANUESHMËRIA E ANKIMEVE

A. Ankimi rreth mungesës së trajtimit mjekësor të mjaftueshëm gjatë periudhës së paraburgimit

61. Qeveria parashtroi se ankuesi nuk kishte mundur të paraqiste ankimet e tij në gjykatat e brendshme sipas nenit 3 të Konventës dhe se kjo pjesë e ankimit për rrjedhojë duhet të shpallet e papranueshme për mosezaurim të mjeteve të brendshme ligjore.

62. Në vëzhgimet e tij ankuesi pohoi se atij nuk i ishte siguruar trajtim mjekësor i mjaftueshëm në qelitë e paraburgimit në Berat.

63. Gjykata rithekson se rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme ligjore i përmendur në nenin 35 të Konventës, detyron ata që kërkojnë të paraqesin çështjen e tyre kundër shtetit para Gjykatës, të përdorin fillimisht mjetet e parashikuara nga sistemi ligjor kombëtar (shih Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, 7 dhjetor 1976, § 48, seria A nr. 24). Ankimet duhet të ishin depozituar pranë organit përkatës të brendshëm, të paktën në thelb dhe në përputhje me kërkesat formale dhe afatet kohore të përcaktuara në ligjin e brendshëm dhe më tej, që duhet të ishte përdorur çdo mjet procedural, i cili mund të parandalonte shkeljen e Konventës (shih Cardot kundër Francës 19 mars 1991, § 34, seria nr. 200).

64. Gjykata vëren se nuk ka informacion që ankuesi të ketë bërë ankime kundër policisë pranë autoritetit përkatës të brendshëm administrativ, për shembull prokurorisë, rreth pamundësisë për t’i siguruar atij trajtim mjekësor të mjaftueshëm gjatë periudhës së paraburgimit. Ajo vëren më tej se ankuesi nuk paraqiti ndonjë ankim të ngjashëm, të paktën në thelb, në procedimet e gjykimit dhe apelit.

65. Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se ankuesi nuk arriti të ezauronte mjetet e brendshme ligjore të parashikuara nga sistemi i brendshëm ligjor. Rrjedhimisht, ajo rrëzon ankimin e ankuesit në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

B. Ankimi rreth kohëzgjatjes së paraburgimit

66. Qeveria argumentoi se kohëzgjatja e paraburgimit të ankuesit ka qenë në përputhje me afatet kohore të parashikuara në legjislacionin e brendshëm dhe nenin 5 § 3 të Konventës. Ata këmbëngulën se kundërshtimi i ankuesit ndaj kohëzgjatjes së paraburgimit të tij ishte rrëzuar nga gjykatat e brendshme të të gjitha niveleve.

67. Ankuesi pohoi se paraburgimi i tij kishte zgjatur më shumë se afatet kohore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe ishte në shkelje të nenit 5 § 3 të Konventës.

68. Gjykata rithekson se paraburgimi përfundon për qëllimet e Konventës me shpalljen e fajësisë dhe dënimin e vendosur në shkallën e parë (shih B. kundër. Austrisë, 28 mars 1990, §§ 34 – 40, seria A nr. 175; Solmaz kundër Turqisë, nr. 27561/02, § 26, ECHR 2007-....., (ekstrakte).

69. Gjykata vëren se paraburgimi i ankuesit filloi më 18 mars 1998. Ai zgjati deri në 11 maj 2000, datë në të cilën Gjykata e Rrethit Fier dha vendimin e saj, duke e dënuar ankuesin. Pas asaj date, ankuesi nuk u përfshi në ndonjë mjet ligjor efektiv të synuar për kundërshtimin e kohëzgjatjes së paraburgimit të tij. Apeli i tij kushtetues nuk mund të konsiderohet si një mjet ligjor efektiv për qëllim të nenit 5 të Konventës (shih, në të kundërt, paragrafin 74 më poshtë në lidhje me nenin 6).

70. Ankimi i ankuesit u depozitua në Gjykatë më 28 nëntor 2002, më shumë se gjashtë muaj pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Fier.

71. Në këto rrethana, Gjykata çmon se ankuesi ka dështuar të respektojë rregullin e gjashtëmujorit. Rezulton që kjo pjesë e kërkesës duhet të hidhet poshtë sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

C. Ankimet rreth mungesës të së drejtës për avokat dhe pamundësia e marrjes në pyetje të dëshmitarëve

72. Qeveria këmbënguli se ky ankim ishte i papranueshëm pasi ishte depozituar më vonë se periudha gjashtëmujore sipas nenit 35 § 1 të Konventës. Kështu, për shkak të vendimit të Gjykatës Kushtetuese mbi papranueshmërinë të datës 18 nëntor 2003, mjeti ligjor përfundimtar efektiv në kuptim të asaj dispozite ishte në fakt vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 16 tetor 2001, ndërsa ankuesi kishte bërë kërkesën e tij më 28 nëntor 2002.

73. Ankuesi parashtroi në përgjigje, duke iu referuar nenit 131 (f) të Kushtetutës dhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese, se me qëllim që të ezauronte të gjitha mjetet ligjore të brendshme, ankimet individuale duhet të depozitoheshin pranë Gjykatës Kushtetuese nëse dhe kur ata dyshonin për një shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë. Për më tepër, ai u mbështet në vendimin e Gjykatës mbi pranueshmërinë, të marrë në çështjen Balliu kundër Shqipërisë (vendimi), nr. 74727/01.

74. Gjykata rithekson përfundimet e saj në çështjen Balliu kundër Shqipërisë. (vendimi) nr. 74727/01), i konfirmuar më pas në vendimin Beshiri etj., kundër Shqipërisë, (nr. 7352/03, § 32, 22 gusht 2006), ku ajo vendosi se një ankim pranë Gjykatës Kushtetuese konsiderohet mjet ligjor efektiv që duhet të përdoret për qëllime të nenit 35 të Konventës, ku lindën çështje të gjykimit të drejtë. Ajo vëren se e drejta e të paditurit për avokat, duke përfshirë të drejtën për të thirrur dhe marrë në pyetje dëshmitarët, përbën një element të rëndësishëm dhe thelbësor të gjykimit të drejtë të garantuar sipas nenit 6 të Konventës (shih paragrafin 60 më lart dhe 77 në vijim më poshtë). Ajo çmon se nuk ka arsye për të devijuar rrethanat e çështjes në fjalë nga përfundimi i saj në çështjen Beshiri etj.

75. Ankuesi në fakt përfitoi nga ky mjet ligjor. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i datës 18 nëntor 2003 dhe ankuesi e depozitoi ankimin e tij më 28 nëntor 2002. Gjykata çmon se nuk lind asnjë problem në lidhje me respektimin e afatit kohor gjashtëmujor të parashikuar në nenin 35 në lidhje me ankimet e tij rreth padrejtësisë së gjykimit të tij. Për këto arsye, Gjykata hedh poshtë kundërshtimin e Qeverisë.

76. Gjykata çmon se ankimet e ankuesit sipas nenit 6 § 3 (c) dhe (d) ngrenë çështje të faktit dhe ligjit që janë mjaft serioze që përcaktimi i tyre duhet të varet nga shqyrtimi në themel. Nuk është paraqitur asnjë arsye tjetër për shpalljen e tyre të papranueshme. Rrjedhimisht, Gjykata i shpall këto ankime të papranueshme. Në përputhje me vendimin e saj për të zbatuar nenin 29 § 3 të Konventës (shih paragrafin 4 më lart), Gjykata tashmë do t'i shqyrtojë këto ankime në themel.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 TË KONVENTËS

77. Gjykata në fillim rithekson se kërkesat e paragrafit 3 (c) dhe (d) të nenit 6 duhet të shihen si aspekte të veçanta të së drejtës për gjykim të drejtë të garantuara nga paragrafi 1. Për këtë arsye, Gjykata e çmon të nevojshme të shqyrtojë ankimet e ankuesit nga pikëpamja e paragrafit 3, të marra së bashku me parimet e mishëruara në paragrafin 1. Gjykata shqyrton, në përputhje me praktikën e saj normale, nëse procedimet ishin në tërësi të drejta (shih Van Geyseghem kundër Belgjikës [GC], nr. 26103/95, § 27, ECHR 1999-I, dhe Balliu kundër Shqipërisë, nr. 74727/01, § 25, 16 qershor 2005).

A. Shkelja e pretenduar e nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (c)

1. Parashtrimet e palëve

78. Ankuesi fillimisht pretendoi se në procedimet ligjore ai nuk ishte përfaqësuar nga një

avokat gjatë fazave të gjykimit të tij, siç kërkohej nga nenet 6 §§ 1 dhe 3 (c) të Konventës.

79. Ankuesi kundërshtoi vërtetësinë e procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 11 maj 2000 që supozohej të deklaronte se ai kishte rënë dakord “të vetëmbrohej”. Ai shtoi se, meqë parashtrimet përfundimtare ishin bërë në gjykatën e rrethit në atë seancë gjyqësore, ai nuk kishte njohurinë minimale ligjore për t’u vetëmbrojtur personalisht dhe për të nxjerrë përfundime të formës së prerë mbi akuzat penale të ngritura kundër tij.

80. Ankuesi vërejti se gjykata e rrethit nuk garantoj caktimin e një avokati tjetër me zgjedhjen e saj, sipas seksionit 49 § 5 të Kodit të Procedurës Penale. Gjukata e brendshme gjithashtu nuk kishte marrë masa disiplinore në lidhje me avokatin mbrojtës të ankuesit për pamundësinë e tyre të vazhdueshme për t’u paraqitur në seanca gjyqësore gjatë gjykimit.

81. Qeveria rrëzoi pretendimet e ankuesit. Ata këmbëngulën se që nga koha kur filloi hetimi, ankuesi kishte pasur mjetet ligjore për t’u përfaqësuar nga një avokat. Gjukata e rrethit kishte shtyrë seancat gjyqësore në disa raste për shkak të mungesës së avokatëve të ankuesit, duke i dhënë kështu ankuesit mundësinë të përfaqësohej dhe të vetëmbrohej në nivel të mjaftueshëm.

82. Për më tepër, ankuesi nuk kishte bërë kërkesë për marrjen e masave disiplinore kundër këtyre avokatëve. Ai gjithashtu nuk i kishte kërkuar gjykatës të caktonte një avokat me zgjedhjen e saj, sipas seksionit 49 § 5 të Kodit të Procedurës Penale.

83. Qeveria pohoi se ankuesi, në seancën përfundimtare të datës 11 maj 2000 në gjykatën e rrethit, kishte deklaruar se dëshironte “të vetëmbrohej”.

84. Në parashtrimet e Qeverisë, këmbëngulja e ankuesit për t’u përfaqësuar nga avokatë që kishin munguar pa arsye ose që ishin tërhequr nga mbrojtja, kombinuar me miratimin e tij për t’u vetëmbrojtur personalisht në seancën përfundimtare, nuk çon në një shkelje të të drejtave të tij kushtetuese.

2. Vlerësimi i gjykatës

85. Gjukata rithekson se ndërsa neni 6 § 3 (c) i jep çdo të akuzuari për një vepër penale të drejtën “për t’u vetëmbrojtur personalisht ose përmes ndihmës ligjore...”, ajo nuk përcakton mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejte. Kështu, ajo i lë shteteve kontraktuese zgjedhjen e mjeteve të sigurimit që garantohej në sistemet e tyre ligjore, pra detyrën e Gjukatës vetëm për të përcaktuar nëse metoda që ata kanë zgjedhur është e pajtueshme me kërkesat e një gjykimit të drejtë (shih vendimin e Quaranta kundër Zvicrës të datës 24 maj 1991, seria A nr. 205, fq. 16, § 30). Në lidhje me këtë, duhet pasur parasysh se Konventa synon të “garantojë jo të drejtat që janë teorike ose të gabuara, por të drejtat që janë praktike dhe efektive” dhe se caktimi i një avokati mbrojtës nuk garanton në vetvete efektivitetin e ndihmës që ai mund t’i japë një të padituri (shih vendimin e Imbrioscia kundër Zvicrës, të datës 24 nëntor 1993, seria A nr. 275, fq. 13, § 38, dhe vendimin e Artico kundër Italisë, të datës 13 maj 1980, seria A nr. 37, fq. 16, § 33).

86. Më tej, Gjukata rithekson se as forma, as përmbajtja e nenit 6 të Konventës nuk ndalon një person të heqë dorë me vullnetin e tij të lirë ose shprehimisht, ose në mënyrë të heshtur, nga e drejta për garanci për një gjykim të drejtë (shih Hermi kundër Italisë [GC], nr. 18114/02, § 73, ECHR 2006-...). Megjithatë, kjo dorëheqje, për të qenë efektive për qëllimet e Konventës, duhet të vendoset në mënyrë të qartë dhe të shoqërohet me garanci minimale në raport me rëndësinë e saj (shih Poitrimol kundër Francës, 23 nëntor 1993, § 31, seria A nr. 277-A). Për më tepër, ajo nuk duhet të bjerë ndesh me interesa të rëndësishme publike (shih Håkansson dhe Stureson kundër Suedisë, 21 shkurt 1990, § 66, seria A nr. 171-A, dhe Sejdivic kundër Italisë [GC], nr. 56581/00, § 86, ECHR 2006-II).

87. Në çështjen në fjalë, ankuesi kishte të drejtë për avokatë sipas zgjedhjes së tij, që kundërshtonin argumentet e prokurorit dhe merrnin në pyetje dëshmitarët. Nuk ka të dhëna se ankuesi, duke zgjedhur pesë avokatë, nuk kishte mjete të mjaftueshme për të paguar për ndihmën ligjore në procedimet e gjykimit (shih, në të kundërt, Artico kundër Italisë, 13 maj 1980, seria A nr. 37). Përfaqësuesit ligjorë të ankuesit ishin në gjendje të merrnin pjesë efektivisht në gjykim. Në asnjë moment, ankuesi nuk i kishte njoftuar autoritetet për ndonjë vështirësi të ndeshur në përgatitjen e mbrojtjes së tij dhe nuk ka asnjë të dhënë që të tregojë se gjykata e shkallës së parë duhet të ishte angazhuar ndaj situatës së ankuesit me kërkesën e saj si administratore përfundimtare të drejtësisë së procedimeve (shih Cuscani kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 32771/96, § 39, 24 shtator 2002).

88. Gjukata e shkallës së parë garantoj që ankuesi u përfaqësua dhe u mbrojt në nivel të mjaftueshëm, duke shtyrë pothuajse të gjitha seancat gjyqësore kur avokatët e ankuesit nuk ishin të

pranishëm. Në një rast, gjykata e shkallës së parë informoi kërkuesin për të drejtën e tij për të caktuar një avokat tjetër, duke marrë parasysh mungesën e vazhdueshme të përfaqësuesit të tij (shih paragrafin 26 më sipër).

89. Vetëm në dy raste gjykata e shkallës së parë procedoi në mungesë të avokatit të ankuesit, për shkak të dëshirës së hapur të ankuesit për t'u vetëmbrojtur personalisht. Para kësaj periudhe, nga data 8 dhjetor 1999 deri në 7 shkurt 2000 ankuesi e revokoi prokurën e avokatit të tij. Ai nuk i kërkoi gjykatës të caktonte një avokat sipas rregullave të vendosura nga gjykata. Duhet të vërehet se deri në 7 shkurt 2000, janë shtyrë pesë seanca gjyqësore dhe nuk u shqyrtua asnjë provë dhe nuk u pyetën dëshmitarë.

90. Më 7 shkurt 2000 prokurori, me miratimin e ankuesit, procedoi me leximin e deklaratave të dëshmitarëve B. dhe D. Ankuesi nuk i pranoi ato deklaratat. Nuk u mor në pyetje asnjë dëshmitar, megjithëse dëshmitari A. ishte paraqitur në gjykatë për të dëshmuar (shih paragrafin 27 më sipër).

91. Së dyti, nga procesverbali i seancës së fundit të datës 11 maj 2000, rezulton se ankuesi në të vërtetë ra dakord të vetëmbrohej personalisht. Ankuesi ishte në dijeni për procedimet dhe akuzat kundër tij. Megjithatë, Gjkata vëren se në këtë rast ishte bërë një dorëheqje e hapur. Nuk ka asgjë në dosjen e çështjes që të tregojë se në ditën e seancës gjyqësore, kur ai pranoi që të vetëmbrohej personalisht, ankuesi protestoi ndaj autoriteteve të brendshme dhe kërkoi shtyrje të afatit.

92. Është e vërtetë se në apelin e tij, ankuesi shprehu kundërshtime dhe kundërshtoi pa sukses vërtetësinë e procesverbalit. Megjithatë, sipas Gjykatës, ai kundërshtim i bërë në një fazë të mëvonshme dhe i pambështetur nga prova të tjera, nuk mund të mbizotëronte mbi qëndrimin në dukje të prerë të ankuesit më 11 maj 2000.

93. Deklaratat e tre dëshmitarëve u lexuan në seancën gjyqësore të datës 11 maj 2000 (shih paragrafin 25 më sipër). Prokurori dhe ankuesi proceduan me vëzhgimet e tyre përmbyllëse. Gjkata vëren se nuk ka të dhëna që deklaratat e dëshmitarëve të lexuara në seancën gjyqësore të datës 11 maj 2000 kishin rëndësi për provën e fajësisë dhe dënimin e ankuesit. Në të vërtetë, gjykatat e brendshme e konfirmuan këtë. Asnjë provë tjetër nuk u shqyrtua në atë datë ndërsa gjykata e shkallës së parë konstatoi se ka prova të mjaftueshme për të provuar fajësinë dhe dënuar ankuesin. Rrjedhimisht, ajo vendosi të përfundonte procedimet e gjykimit.

94. Është e vërtetë se vëzhgimet përmbyllëse në emër të ankuesit, që padyshim kërkonin njohuri dhe ekspertizë ligjore, nuk u bënë nga avokati i tij. Megjithatë, në procedimet e apelit, ankuesi u përfaqësua nga një avokat sipas zgjedhjes së tij, i cili, gjë që nuk ishte kundërshtuar nga palët, bëri vëzhgime përmbyllëse duke ripohur pafajësinë e tij për akuzat penale të ngritura kundër tij (shih, midis shumë autoriteteve të tjera, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, 16 dhjetor 1992, § 39, seria A nr. 247-B).

95. Duke pasur parasysh përfundimet e mësipërme, Gjkata çmon se fakti që ankuesi nuk u përfaqësua nga një avokat në dy seanca gjyqësore gjatë procedimeve të gjykimit, nuk çoi në një shkelje të nenit 6 § 3 (c) të Konventës në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës.

B. Shkelja e pretenduar e nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d)

1. Parashtrimet e palëve

96. Ankuesi u ankua se refuzimi nga Gjkata e Rrethit Fier e kërkesës së tij për ta lejuar të marrë në pyetje dëshmitarin M. shkeli të drejtën e tij sipas nenit 6 § 3 (d). Ai gjithashtu u ankua se Gjkata e Rrethit Fier nuk ishte e gatshme të urdhëronte dëshmitarët e tij të mbrojtjes të paraqiteshin pranë asaj gjykate. Për më tepër, sipas mendimit të ankuesit, Gjkata e Rrethit Fier nuk mund të merrte parasysh provat e shumë dëshmitarëve që kishin dëshmuar në favor të ankuesit para Gjykatës së Rrethit Berat (shih paragrafin 20 më lart).

97. Ankuesi parashtroi se prova e fajësisë dhe e dënimit të tij për vrasjen e P-së, kryesisht bazoheshin në deklaratat e dëshmitarëve B., C. dhe D., që u morën gjatë hetimit penal. Asnjë prej këtyre dëshmitarëve nuk u paraqit në Gjykatën e Rrethit Fier. Për më tepër, dëshmitari A, nuk kishte qenë i pranishëm në vendin e krimit.

98. Qeveria parashtroi se më 23 shkurt 2000, M. u dëgjua para Gjykatës së Rrethit Fier. Avokatit të ankuesit iu dha mundësia për të marrë në pyetje dëshmitarin, por ai refuzoi të përfitonte nga kjo mundësi. Për rrjedhojë, Gjkata e Rrethit Fier refuzoi kërkesat e mëtejshme të avokatit të ankuesit për marrjen në pyetje të M.

99. Qeveria nuk bëri ndonjë vëzhgim mbi ankimet e mëtejshme të ankuesit sipas këtij kreu.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parime të përgjithshme

100. Gjykata në fillim rithekson se pranueshmëria e provave kryesisht rregullohet nga rregullat e ligjit të brendshëm dhe, si rregull, gjykatat e brendshme duhet të vlerësojnë provat e paraqitura pranë tyre. Detyra e Gjykatës sipas Konventës nuk është të japë vendim nëse deklaratat e dëshmitarëve u pranuan siç duhet si prova, por më tepër të përcaktojnë nëse procedimet në tërësi, duke përfshirë mënyrën në të cilën u morën provat, ishin të drejta (shih vendimin e Balliu, cituar më sipër, § 42).

101. Provat normalisht duhet të paraqiten në një seancë me dyer të hapura, në prani të të paditurit, me qëllim argumentin kundërshtues. Ka përjashtime ndaj këtij parimi, por ato nuk duhet të shkelin të drejtat e mbrojtjes. Si rregull i përgjithshëm, paragrafët 1 dhe 3 (d) të nenit 6 kërkojnë që të paditurit t'i jepet mundësi e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të kundërshtuar dhe marrë në pyetje një dëshmitar kundër tij, qoftë kur ai bën deklaratat e tij ose në një fazë të mëvonshme të procedimeve (shih Lüdi kundër Zvicrës, 15 qershor 1992, § 47, seria A nr. 238, dhe Van Mechelen etj kundër Holandës, 23 prill 1997, § 51, procesverbalet 1997-III). Normalisht, gjykatat kombëtare duhet të vendosin nëse është e nevojshme ose e këshillueshme të dëgjojnë një dëshmitar të caktuar. Neni 6 § 3 (d) nuk kërkon pjesëmarrjen dhe marrjen në pyetje të çdo dëshmitari në emër të të paditurit: qëllimi i tij kryesor, siç tregohet nga fjalët “nën të njëjtat kushte”, është një “barazi e plotë procedurale e prokurorisë dhe mbrojtjes” në çështje (shih, për shembull, Polufakin dhe Chernyshev kundër Rusisë, nr. 30997/02, § 205, 25 shtator 2008).

102. Nën rrethana të caktuara mund të jetë e nevojshme për gjykatat që të kenë rekurs ndaj deklaratave të bëra gjatë fazës së hetimit penal. Nëse i pandehuri kishte mundësi të mjaftueshme për të kundërshtuar këto deklarata, në kohën kur ato janë marrë ose në një fazë të mëvonshme të procedimeve, përdorimi i tyre nuk bie ndesh me garancitë e nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d). Të drejtat e mbrojtjes janë të kufizuara në një shkallë që është e papajtueshme me kërkesat e nenit 6 nëse dënimi bazohet vetëm, ose në mënyrë përfundimtare, në dëshmitë nën besim të një dëshmitari, të cilin i padituri nuk kishte asnjë mundësi për ta marrë në pyetje ose ta kishte marrë në pyetje gjatë hetimit, apo në gjykim (shih Vozhigov kundër Rusisë, nr. 5953/02, § 51, 26 prill 2007; Lucà kundër Italisë, nr. 33354/96, § 40, ECHR 2001-II; dhe Solakov kundër “Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë”, nr. 47023/99, § 57, ECHR 2001-X).

b) Ankimi për çështjen në fjalë

103. Gjykata vëren se ankuesi pretendon për një shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d) të Konventës, kryesisht për dy arsye: (i) në lidhje me akuzën e vrasjes së mbetur në tentativë të punonjësve të policisë, ai nuk kishte mundur të merrte në pyetje dëshmitarin M., disa dëshmitarë mbrojtjeje nuk ishin paraqitur para Gjykatës së Rrethit Fier dhe kjo e fundit nuk kishte marrë parasysh dëshmitë e disa dëshmitarëve të dhëna në favor të ankuesit para Gjykatës së Rrethit Berat; dhe, ii) në lidhje me vrasjen e dyshuar të P., ai nuk kishte mundur të merrte në pyetje dëshmitarët, mbi fuqinë e deklaratave të të cilëve ai ishte dënuar.

i) Akuza e vrasjes së mbetur në tentativë të punonjësve të policisë më 18 mars 1998

104. Gjykata vëren se dënimi i ankuesit për vrasjen e mbetur në tentativë të punonjësve të policisë më 18 mars 1998 ishte bazuar, ndër të tjera, në dëshmitë e katër punonjësve të policisë K., L., M. dhe N. (shih paragrafin 37 më lart).

a) Dëshmitarët e akuzës

105. Në seancat gjyqësore të datave 23 shkurt dhe 1 e 21 mars 2000, ankuesi kërkoi pa sukses të lejohej të merrte në pyetje M. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se dënimi i ankuesit nuk ishte bazuar në “një shkallë vendimtare” ose vetëm në dëshminë e M. në gjykatën e shkallës së parë. Kur autoritetet e brendshme gjyqësore përballen me disa versione kontradiktore të së vërtetës të ofruara nga i njëjti person, preferenca e tyre përfundimtare për një deklaratë të dhënë autoriteteve hetimore ndaj një deklarate të dhënë në një gjyq me dyer të hapura, nuk ngre në vetvete një çështje sipas Konventës kur kjo preferencë është e bazuar dhe vetë deklarata ishte dhënë me dëshirën e personit (shih Lutsenko kundër Ukrainës, nr. 30663/04, § 49, 18 dhjetor 2008). Ndërsa dëshmia e M. ishte e rëndësishme, u vërtetua nga prova të tjera materiale, si për shembull raporti hetimor i vendit të krimit, raporti i arrestimit të ankuesit dhe raporti balistik dhe, kryesisht, dëshmitarë, si K., L. dhe N., që u morën në pyetje nga ankuesi. Për më tepër, ankuesi nuk parashtrroi asnjë argument bindës që të shpjegonte se marrja në pyetje e M. do të kishte qenë thelbësore për krijimin e fakteve të çështjes dhe përfshirjen e tij në veprën penale.

106. Rezulton që nuk ka pasur asnjë shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me 6 § 3 (d) të Konventës për shkak të refuzimit të Gjykatës për të lejuar ankuesin të marrë në pyetje M.

B) Dëshmitarët e mbrojtjes

107. Në seancën gjyqësore të 1 marsit 2000, në vijim të kërkesës së ankuesit, Gjykata e Rrethit Fier lëshoi disa fletëthirrje për paraqitjen e tre punonjësve të policisë O., Q. dhe S. Megjithatë, këta dëshmitarë të mbrojtjes nuk u paraqitën asnjëherë para gjykatës së shkallës së parë.

108. Ndërsa më 11 maj 2000 ankuesi duket të ketë hequr dorë nga e drejta e tij për të marrë në pyetje dëshmitarin O. dhe lejoi leximin e deklaratave të dëshmitarëve Q. dhe S., ky ishte rezultati i zhgënjimit të tij mbi përpjekjet e vazhdueshme dhe të pasuksesshme nga autoritetet për t'i thirrur ata. Gjykata vëren se dëshmitë e tre punonjësve të policisë përbënin prova me, të paktën, rëndësi *prima facie* për mbrojtjen e ankuesit. Pamundësia e shtetit që është paditur (domethënë Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Policisë) për të siguruar pjesëmarrjen e punonjësve të policisë që veprojnë si depozitues të autoritetit publik përgjegjës për mbrojtjen e interesave të përgjithshme të shtetit, kombinuar me pamundësinë e gjykatës së shkallës së parë për të siguruar zbatimin e fletëthirrjes së saj, nuk arrin të sigurojë vullnetin që shtetet kontraktuese duhet të ushtrojnë me qëllim që të sigurojnë që të drejtat e garantuara nga neni 6 të gëzohen në mënyrë efektive (shih Sadak etj kundër Turqisë, nr. 29900/96, 29901/96, 29902/96 dhe 29903/96, § 67, ECHR 2001-VIII, dhe vendimin e Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës, të datës 6 dhjetor 1988, seria A nr. 146, fq. 33, § 78). Gjykatat e apelit nuk e rregulluan këtë shkelje, megjithëse ankuesi e kërkoi këtë në arsyet e tij të apelit. Qeveria nuk dha shpjegime për këtë ose nuk u përpoq të justifikonte përse punonjësit e policisë nuk mund të paraqiteshin në gjykatë.

109. Rezulton se në këtë drejtim ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës.

110. Gjykata vëren se katër dëshmitarët dëshmuan në favor të ankuesit para Gjykatës së Rrethit Berat (shih paragrafin 20 më sipër). Meqenëse të gjitha aktet e Gjykatës së Rrethit Berat ishin transferuar në mënyrë të arsyetuar në Gjykatën e Rrethit Fier, ankuesi mund të mos kërkonte paraqitjen e tyre. Gjykata e Rrethit Fier përjashtoi dëshmitë e tyre kur dha vendimin e saj, pa dhënë arsye mbi këtë. Qeveria nuk parashtroi argumente që justifikonin këtë përjashtim. Ndërsa Gjykata nuk mund të spekulojë në lidhje me rëndësinë e elementeve faktikë, gjykata e shkallës së parë nuk mori në konsideratë, pa justifikim, të gjitha provat e dëshmitarëve në favor të ankuesit, dhe këto prova sigurisht ishin të rëndësishme për çështjen dhe rrjedhimisht për vendimin.

111. Rezulton që në këtë drejtim ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës.

ii) Akuza e vrasjes së P. më 21 korrik 1997

112. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Rrethit Fier që dënonte ankuesin për vrasjen e P. ishte bazuar tërësisht në dëshminë e A. dhe deklaratat e dëshmitarëve B., C. dhe D. të dhëna gjatë hetimit penal. Ky arsyetim u mbështet në apel.

113. Gjykata vëren se në procedurën penale shqiptare, gjykata e apelit ka juridiksionin të trajtojë jo vetëm çështje të ligjit, por edhe çështje të faktit në lidhje me tërësinë e çështjes. Gjykata e apelit është e autorizuar të shqyrtojë provat dhe materialet e reja shtesë të paraqitura nga palët, siç e çmon të nevojshme. Si rezultat i shqyrtimit, gjykata e apelit mund të rrëzojë apelin dhe të mbështesë vendimin, të ndryshojë vendimin ose të shfuqizojë vendimin dhe të përfundojë procedimet penale ose të shfuqizojë vendimin dhe të paraqesë çështjen për rigjykim. Gjykata e Lartë trajton çështjet e ligjit të ngritura në apelin e ankuesit.

114. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se A. nuk ishte as dëshmitarë okulare, as e pranishme në vendin e krimit. Dëshmia e saj u bazua në deklaratat e dëshmitarëve B., C. dhe D., që ishin bërë gjatë hetimit penal. As ankuesi, as avokati i tij nuk mund të përballeshin me këta dëshmitarë kryesorë ose të bënin pyetje ose komente në lidhje me ato deklaratat, meqë në atë kohë nuk ishte ngritur asnjë akuzë kundër tij (shih paragrafin 7 më sipër).

115. Për më tepër, Gjykata çmon se ankuesi nuk hoqi dorë nga e drejta e tij për të marrë në pyetje ata dëshmitarë. Më 7 shkurt 2000 ai kundërshtoi leximin e deklaratave të tyre dhe kërkoi paraqitjen e tyre para Gjykatës së Rrethit Fier. Gjykata sërish rithekson përfundimet e saj në paragrafin 108 më sipër. Gjykata nuk është e bindur se autoritetet ishin të zellshme në përpjekjet e tyre për të sjellë dëshmitarët para gjykatës së shkallës së parë. Mosparaqitja e këtyre dëshmitarëve, deklaratat e të cilëve ishin vendimtare për dënimin e ankuesit, e parandaloi ankuesin nga marrja e tyre në pyetje ose nga marrja e tyre e mëparshme në pyetje. Ky mosveprim nuk u rregullua as nga gjykata e apelit që ishte e autorizuar të shqyrtonte çështjet e faktit dhe të ligjit, as nga Gjykata e Lartë.

116. Duke marrë në konsideratë faktorët e mësipërm, Gjykata rrjedhimisht nxjerr përfundimin se në këtë drejtim ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

117. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Nëse Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose protokolleve të saj dhe nëse ligji i brendshëm i palës së lartë kontraktuese përkatëse lejon vetëm kryerjen e një kompensimi të pjesshëm, nëse është e nevojshme, Gjykata do t’i japë kompensim të drejtë palës së dëmtuar.”

118. Ankuesi theksoi se ai kishte qenë në burg për të paktën 114 muaj ose 3,400 ditë deri në kohën që parashitroi vërejtjet e tij në Gjykatë. Ai kërkoi pagesën e 136,000 euro në lidhje me dëmin financiar që kishte pësuar. Ankuesi nuk përcaktoi ndonjë shumë në lidhje me dëmin jofinanciar, megjithëse specifikoi se sipas ligjit të brendshëm, kishte të drejtë për kompensim. Ai gjithashtu specifikoi se në raste të ngjashme gjykatat e brendshme kishin kompensuar dëme jofinanciare në shumën prej 100,000 eurosh.

119. Qeveria rrëzoi pretendimin e ankuesit për kompensim të drejtë.

A. Dëmi

120. Për sa i përket dëmit financiar që pretendohet të jetë shkaktuar, Gjykata rithekson se duhet të ketë një lidhje të qartë shkakësore midis dëmit të pretenduar nga ankuesit dhe shkeljes së Konventës (shih, ndër të tjera, Dybeku kundër Shqipërisë, nr. 41153/06, § 65, 18 dhjetor 2007).

121. Gjykata, duke marrë parasysh përfundimet e saj në lidhje me ankimet e ankuesit sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) dhe (d), çmon se nuk është vendosur asnjë lidhje shkakësore midis dëmit të pretenduar dhe shkeljeve që ka konstatuar. Gjykata nuk mund të spekulojë se cili mund të kishte qenë rezultati i procedimeve penale kundër ankuesit nëse nuk do të kishte ndodhur shkelja e Konventës (shih Polufakin dhe Chernyshev, cituar më sipër, § 216). Rrjedhimisht, Gjykata e çmon të papërshtatshme që t’i japë ankuesit kompensim për dëmin e pretenduar financiar.

122. Në shkallën që pretendimi i ankuesit lidhet me rezultatet e shkeljeve të nenit 6 § 3 (d) në lidhje me neneve 6 § 1, Gjykata rithekson se kur një kërkues është dënuar, pavarësisht një shkeljeje të mundshme të të drejtave të tij, siç garantohet nga neni 6 i Konventës, ai duhet, sa më shumë të jetë e mundur, të vihet në një pozicion në të cilin do të kishte qenë, nëse kërkesat e asaj dispozite nuk do të ishin marrë parasysh dhe që forma më e përshtatshme e kompensimit, në parim, do të ishte gjykimi *de novo* ose rifillimi i procedimeve, nëse do të kërkohej (shih Salduz kundër Turqisë [GC], nr. 36391/02, § 72, 27 nëntor 2008; Polufakin dhe Chernyshev, cituar më sipër, § 219; Öcalan kundër Turqisë [GC], nr. 46221/99, § 210 në gjobë, ECHR 2005-IV; dhe Popov kundër Rusesë, nr. 26853/04, § 263, 13 korrik 2006).

123. Për sa i përket pjesës së mbetur të pretendimit për dëm jofinanciar, duke vendosur mbi baza të barabarta, Gjykata i jep ankuesit 3,000 EURO plus çdo taksë që mund të vendoset mbi këto shuma.

B. Kostot dhe shpenzimet

124. Ankuesi i cili mori 850 euro në ndihmën ligjore nga Këshilli i Europës në lidhje me paraqitjen e çështjes së tij, përveç kësaj kërkoi 500 euro në muaj për kostot e udhëtimit të anëtarëve të familjes së tij për ta vizituar atë në mjediset e paraburgimit dhe për shpenzimet ushqimore të shkaktuara ndërsa ishte në paraburgim. Nuk u ngrit asnjë pretendim tjetër në lidhje me kostot dhe shpenzimet e shkaktuara pranë gjykatave të brendshme dhe kësaj Gjykate.

125. Gjykata e hodhi poshtë pretendimin.

126. Gjykata vëren se asaj nuk i është dhënë dokumentacioni përkatës që tregon se shpenzimet e pretenduara në fakt ishin shkaktuar. Rrjedhimisht, Gjykata nuk do të bëjë një kompensim sipas këtij kreu.

C. Kamatëvonesa

127. Gjykata e çmon të nevojshme që kamatëvonesa të bazohet në normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane, së cilës duhet t’i shtohen tri pikë në përqindje.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NJEZËRI:

1. Shpall ankimet në lidhje me nenin 6 të Konventës të pranueshme dhe pjesën e mbetur të kërkesës të papranueshme.

2. Vendos se nuk ka pasur asnjë shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (c) të Konventës mbi mungesën e së drejtës së ankuesit për avokat gjatë fazave të gjyimit të tij.

3. Vendos se nuk ka pasur asnjë shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës mbi refuzimin e gjykatës së shkallës së parë për të lejuar ankuesin të marrë në pyetje dëshmitarin M.

4. Vendos se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës mbi pamundësinë për të garantuar paraqitjen në gjykimin e ankuesit të dëshmitarëve O., Q. dhe S.

5. Vendos se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës mbi pamundësinë e gjykatës së shkallës së parë për të marrë në konsideratë dëshmitë e katër dëshmitarëve të dhëna në favor të ankuesit para Gjykatës së Rrethit Berat.

6. Vendos se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës mbi pamundësinë për të garantuar paraqitjen në gjykimin e ankuesit të dëshmitarëve B., C. dhe D.

7. Vendos:

a) se shteti i paditur duhet t'i paguajë ankuesit brenda tri muajve nga data në të cilën vendimi ka marrë formë të prerë, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës 3,000 euro (tre mijë euro) në lidhje me dëmin jofinanciar, plus çdo taksë që mund të vendoset, e cila duhet të konvertohet në monedhën kombëtare të shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e pagesës.

b) se nga skadimi i tre muajve të lartpërmendur deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të paguhet në shumën e mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit të detyrimeve financiare, plus tri pikë në përqindje.

8. Rrëzon pjesën e mbetur të pretendimit të ankuesit për kompensim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim, më 8 dhjetor 2009, sipas nenit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Lawrence Early
Sekretar

Nicolas Bratza
Kryetar